



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministry of Education, Science and Technology
Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije

Projekti Mbështetje Teknike për MASHT (FBSA) Kosovë
Technical Assistance to MEST (ESPF) Kosovo Project

Shqyrtim i Strukturës së Programeve të Shpenzimeve në Sektorin e Arsimit

**Propozim për Strukturë të Programeve të Shpenzimeve në
Nivel Mbarë Sektorial dhe në Nivel Organizate Buxhetore**

Mars 2015

Përmbajtja

Hyrje	1
Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Sektorit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.....	1
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	1
Universiteti i Prishtinës.....	1
Krahasimi i Strukturës të Buxhetit me Shtetet në Rajon.	2
Struktura Buxhetore e Sektorit të Arsimit, Republika e Shqipërisë, Buxheti 2015.....	2
Struktura Buxhetore e Sektorit të Arsimit, Mali i Zi, Buxheti 2015.....	2
Struktura Buxhetore e Sektorit të Arsimit, Maqedoni, Buxheti 2015	3
Struktura buxhetore e Sektorit të Arsimit, Serbi, Buxheti 2014	4
Struktura Buxhetore e Arsimit, Kosovë, Buxheti 2015.....	5
Ndërlidhja me Sistemin e Planifikimit të Integruar	5
Struktura e Propozuar Mbarë-Sektoriale me theks të veçantë në MASHT	6
Përmirësimet e mundshme të menjëhershme.	9
Ndërlidhja e strukturës së re të propozuar mbarësektoriale me indikatorët e performancës	11
Shtojca 1: Draft Struktura e KASH-it Sektorial.....	13
Shtojca 2: Struktura e Propozuar për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	14
Shtojca 3: Struktura e Propozuar e Buxhetit për ARsimin në Nivelin Komunal	15
Shtojca 4: Struktura e Programit	16

Hyrje

Sektori i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë menaxhohet nga 3 Organizata Buxhetore në nivel qendror, dhe nga Komunitet në nivel komunal. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për këtë sektor, si edhe në të kaluarën, përgatitet në nivel organizate buxhetore, dhe resurset strategjike për periudhën afatmesme ndahen për organizata buxhetore e jo për sektorë apo për politikatat të cilat zbatohen nga sektori.

Kjo situatë mund të shihet edhe në Kornizën Afatmesme 2015-2017, ku resurset për Sektorin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ndahen për 3 organizata buxhetore në nivel qendror (ASHAK, MASHT dhe UP), si dhe për komunitet në formë të grantit të përcaktuar për arsim.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Sektorit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka prezantuar këto objektiva:

1. Gjithëpërfshirja dhe përmirësimi i cilësisë në arsimin parauniversitar;
2. Rritja e pjesëmarrjes dhe sigurimi i cilësisë së lartë në arsimin e lartë dhe nxitja e veprimtarisë kërkimore – shkencore;
3. Menaxhimi cilësor dhe zhvillimi i sektorit të arsimit.

Gjithashtu, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në KASH ka paraqitur treguesit e performancës në nivel programi.

Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) në KASH 2015 – 2017, ka paraqitur këto objektiva:

1. Realizimi i projektit “Fjalori Enciklopedik në kuadër të “Enciklopedisë së Kosovës” (projekt afatgjatë);
2. Veprimtaria botuese e Akademisë (botimi i rezultateve të studimeve shkencore);
3. Veprimtaria afatgjatë e Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe (në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë)

Duhet të theksohet se këto objektiva janë të përcaktuara në nivel të organizatës buxhetore e cila në buxhetin 2015 është ekuivalente me linjën buxhetore (program dhe nënprogram).

Universiteti i Prishtinës

Universiteti i Prishtinës (UP) në KASH 2015-2017 ka paraqitur këto objektiva:

1. Ngritja e cilësisë në studime dhe mësimdhënie;
2. Avancimi i kërkimeve shkencore në UP – shndërrimi i universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe hulumtimeve shkencore,
3. Zgjerimi dhe mirëmbajtja e objekteve të arsimit të lartë;
4. Ngritja dhe avancimi i sistemit informativ.

Njëjtë si në rastin e ASHAK-ut, objektivat në KASH janë të përcaktuara në nivel të organizatës buxhetore e cila në buxhetin e vitit 2015 është ekuivalente me linjën buxhetore (“program” dhe “nënprogram”).

Mirëpo bazuar në raportin e vlerësimit të mangësive në sektorin e arsimit, shkencës dhe teknologjisë, i përgatitur nga Projekti për Mbështetjen e MASHT-it është vlerësuar që KASH/Buxheti sipas strukturës aktuale nuk është i përshtatshëm për të mbështetur buxhetimin e sektorit në bazë të politikave. Buxheti për vitin 2015 ende ka nevojë për përmirësim në drejtim të planifikimit të duhur afatmesëm.

Andaj, si rrjedhojë e kësaj gjendje është parashtruar nevoja e rishikimit të strukturës aktuale të buxhetit në sektorin e arsimit për të arritur disa qëllime:

- a) Ndërlidhjen e strukturës së buxhetit me objektivat strategjike të sektorit;
- b) Avancimin e mëtutjeshëm të procesit të planifikimit strategjik në sektorin e arsimit;
- c) Mundësinë e gjetjes së kursimeve nga ristrukturimi i programeve buxhetore.

Për më tepër, në sektorin e arsimit në përputhje me praktikën më të mira të planifikimit do të rekomandohet rishikimi i strukturës ekzistuese të programeve buxhetore për të siguruar një ndërlidhshmëri të drejtpërdrejtë me objektivat strategjike të sektorit dhe të njëjtën kohë implementimi i programeve të caktuara buxhetore të jetë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuara sektoriale.

Krahasimi i Strukturës të Buxhetit me Shtetet në Rajon.

Në vijim është paraqitur struktura e buxheteve të institucioneve arsimore të shteteve në regjion e ndarë sipas programeve buxhetore.

Struktura Buxhetore e Sektorit të Arsimit, Republika e Shqipërisë, Buxheti 2015.

Republika e Shqipërisë, shteti i vetëm në rajon i suksesshëm në reformën buxhetore, ka një strukturë mjaftë të thjeshtë, e të bazuar në politika, të buxhetit për sektorin e arsimit. Struktura e njëjtë përdoret edhe për Programin Afatmesëm Buxhetor (ekuivalent me KASH) edhe për buxhet.

Buxheti i sektorit të Arsimit në Republikën e Shqipërisë menaxhohet në kuadër të një institucioni buxhetor me 7 programe buxhetore si në vijim:

Institucioni Buxhetor	Programi Buxhetor
Ministria e Arsimit dhe Sporteve	Planifikim, Menaxhim dhe Administratë
	Arsimi Bazë (përfshirë parashkollorin)
	Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)
	Arsimi i Mesëm (profesional)
	Arsimi Universitar
	Fonde për Shkencën
	Zhvillimi i Sportit

Struktura Buxhetore e Sektorit të Arsimit, Mali i Zi, Buxheti 2015

Ministria e Malit të Zi gjithashtu menaxhon me buxhetin e arsimit në nivel programi, që në vitin 2015 ka një strukturë mjaftë të thjeshtë por gjithëpërfshirëse. Një veçanti e këtij shteti është se projektet për ndërtimin e ndërtesave të arsimit dhe shkencës buxhetohen në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pra, buxheti arsimit në Republikën e Malit të Zi menaxhohet nga dy institucione buxhetore, dhe në kuadër të 10 programeve buxhetore si në vijim:

Institucioni Buxhetor	Programi Buxhetor
Ministria e Arsimit	Arsimi Parashkollor
	Arsimi Bazë
	Arsimi i Mesëm
	Standardet e Mësimit dhe Studentëve
	Institucioni për Libra Shkollor dhe Material Arsimor
	Arsimi i Lartë dhe Hulumtim
Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm	Ndërtimi dhe Rindërtimi i Ndërtesave të Arsimit dhe Shkencës

Struktura Buxhetore e Sektorit të Arsimit, Maqedoni, Buxheti 2015

Buxheti i arsimit në Republikën e Maqedonisë planifikohet dhe menaxhohet nga dy institucione buxhetor, dhe në kuadër të 11 programeve me një total prej 32 nën-programe. Një strukturë e tillë, njëjtë si ajo e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë është ekstensive, ku si bazë merr klasifikimin e funksional, që jo domosdoshmërisht është në harmoni me politikat kombëtare.

Institucioni Buxhetor	Programi Buxhetor	Nënprogrami Buxhetor	
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Administrata	Administrata	
		Mbështetje në Zbatimin e Strategjisë për Romët	
	Arsimi Bazë	Arsimi Bazë	
		Projekte në Arsimin Bazë	
	Arsimi i Mesëm	Arsimi i Mesëm	
		Projekte në Arsimin e Mesëm	
		Projektet e Arsimit të Mesëm – Mbështetje për Romët	
	Arsimi i Lartë	Arsimi i Lartë	
		Universiteti i Shkupit	
		Universiteti i Manastirit	
		Universiteti i Tetovës	
		Universiteti i Ohrit	
		Ndërtimi i Fakultetit të Shkencave Informatike dhe Inxhinieri Kompjuteri dhe Fakultetit të Kulturës Fizike	
	Standardet Nxënësve	e	Standardet e Nxënësve
	Standardet Studentëve	e	Standardet e Studentëve
	Shkenca		Hulumtimi Shkencor
		Institucionet Shkencore	
		Agjencia Kombëtare për Teknologji Nukleare	
		Programet Laboratorike	
		Projekte për Përkthimin e Librave të Autorëve të Njohur	
Decentralizimi		Bartja e Kompetencave për “ELS”	
Reforma	e	Trajnim dhe Ndërtim i Kapaciteteve	

Administratës Publike	
Integrimi Evropian	Përkrahja për Tranzicion dhe Ndërtim të Institucioneve
Investimet në Arsim	Ndërtimi i Shkollave Fillore
	Rindërtimi i Shkollave Fillore
	Ndërtimi i Shkollave të Mesme
	Rindërtimi i Shkollave të Mesme
	Rindërtimi i sallave të sportit në shkollat e mesme
	Ndërtimi dhe rindërtimi i konvikteve për student

Struktura buxhetore e Sektorit të Arsimit, Serbi, Buxheti 2014

Ministria e Arsimit në Republikën e Serbisë ka një strukturë buxhetore e cila mund të konsiderohet më komplekse në krahasim me vendet tjera fqinje të marra si shembull në këtë studim. Në përgjithësi, struktura e buxhetit është si në vijim:

Institucioni Buxhetore	Kapitulli	Funksioni	Programi	
Ministria e Arsimit	Nuk ka	Hulumtim Bazë	Komponenti 1 i IPA të BE – Përkrahja për Tranzicion dhe Ndërtim Institucionesh	
		Arsimi (N.E.C)	Rregullimi dhe Mbikëqyrja e Sistemit të Arsimit	
	Arsimi Bazë	Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor		Programi Përgatitor dhe Parashkollor Arsimi Fillor
				Komponenti 1 i IPA të BE – Përkrahja për Tranzicion dhe Ndërtim Institucionesh
			Shërbime Mbështetëse për Arsimin	Shërbime Mbështetëse për Arsimin
	Arsimi i Mesëm	Shërbime Mbështetëse për Arsimin	Shërbime Mbështetëse për Arsimin	
	Arsimi i Lartë	Shërbime Mbështetëse për Arsimin	Shërbime Mbështetëse për Arsimin	
	Standardet e Studentëve	Shërbimet Mbështetëse për Arsimin	Shërbime Mbështetëse për Arsimin	
	Instituti për Avancimin e Arsimit	Arsimi (N.E.C)		Rregullimi dhe Mbikëqyrja e Sistemit të Arsimit
				Komponenti 1 i IPA të BE – Përkrahja për Tranzicion dhe Ndërtim Institucionesh
Instituti për Vlerësimin e Cilësisë së Arsimit	Arsimi (N.E.C)		Rregullimi dhe Mbikëqyrja e Sistemit të Arsimit	

Struktura Buxhetore e Arsimit, Kosovë, Buxheti 2015

Kosova ngjashëm me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Serbisë ka një strukturë ekstensive të linjave buxhetore, të cilat mund të jenë të përshtatshme për kontrollim të shpenzimeve në nivel të zërave kontabël të shpenzimeve (kategorive ekonomike), mirëpo nuk është e përshtatshme për buxhetim të politikave dhe prioriteteve të përcaktuara dhe formuluar mirë. Në vijim shihet struktura buxhetore e sektorit të arsimit e cila përbëhet nga 3 organizata buxhetore të nivelit qendror, dhe nga një program dhe 4 nënprograme (linja buxhetore) për secilën organizatë buxhetore të nivelit vendor.

Institucioni Buxhetor	Programi	Nënprogrami
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Arsimi i Lartë dhe Shkenca	Qendra e Studentëve
		Marrëveshjet Bilaterale
		Universiteti i Prishtinës
		Instituti Albanologjik i Prishtinës
		Universiteti i Pejës
		Universiteti i Gjakovës
		Universiteti i Mitrovicës
		Investimet Kapitale në Arsimin e Lartë dhe Shkencë
	Arsimi Parauniversitar	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
		Arsimi për Nevoja të Veçanta
Trajnimi i Mësimdhënësve		
Zhvillimi i Planprogramit		
Programi i Arsimit Bazë		
Agjencia për AAP		
Bashkëfinancimi me Kuvendet Komunale	Bashkë-financimi me KK-të në Veri	
Shërbimet e Administratës	Administrata Qendrore Zyra e Ministrit Inspektorati i Arsimit	
Universiteti i Prishtinës	Universiteti i Prishtinës	Universiteti i Prishtinës
Akademia e Shkencave dhe Arteve	Akademia e Shkencave dhe Arteve	Akademia e Shkencave dhe Arteve
Komunat e Ndryshme	Arsimi dhe Shkenca	Administrata
		Arsimi Parashkollor
		Arsimi Fillor
		Arsimi i Mesëm

Ndërlidhja me Sistemin e Planifikimit të Integruar

Ashtu siç është paraqitur më lartë dhe siç është gjetur në hulumtimin e mangësive të sektorit, kjo strukturë buxhetore e miratuar në Buxhetin 2015, nuk mbështetë në masë të duhur politikat e prezantuara të sektorit të arsimit në KASH 2015-2017 dhe buxhetimi është më tepër i bazuar në prioritizimin e institucioneve se sa të politikave arsimore gjë që njihet si buxhetim i bazuar në inpute. Kjo do të thotë, se ky buxhetim nuk mundëson matjen e drejtpërdrejtë të inputeve që ndërlidhen me realizimin e një politike/programi si dhe koston përkatëse. Një situatë e tillë sjellë në pikëpyetje efektivitetin e shpenzimeve publike si dhe vështirëson matjen e suksesit/performancën e një politike të caktuar karshi fondeve të shpenzuara për atë politikë.

Në Harten e Sistemit të Planifikimit të Integruar në kuadër të propozimeve të procesit të planifikimit janë propozuar të krijohen dy nivele të strukturave koordinuese dhe menaxhuese.

- **Komisioni për Menaxhim Strategjik** – Niveli më i lartë politik dhe administrativ strategjik, dhe
- **Komisionet Programore** – niveli administrativ dhe ekspertë që siguron koordinimin dhe zbatimin e vendimeve strategjike, vlerësimin të mangësive, i përgatitur nga projekti për mbështetjen e MASHT-it.

Me qëllim të avancimit të politikëbërjes, prioritizimit të politikave, sigurimit të zbatimit të tyre në të gjitha nivelet në sektorin e arsimit, struktura e komisioneve programore të propozuara në raportin e IPS-it duhet të jetë plotësisht e ndërlidhur me strukturën e re të propozuar buxhetore. Kjo për qëllim se një strukturë e tillë do të mundësonte “komunikimin” e drejtpërdrejtë të komisioneve përkatëse me politikat e propozuara si dhe do të mundësohej përcjellja e implementimit të tyre dhe matja me indikator përkatës.

Në këtë kontekst në kuadër të propozimit për themelimin e Komisioneve Programore, themelimi i Komisionit Programor për Investime Kapitale duhet të rishqyrtohet, kjo për arsye që në raste të caktuara investimet kapitale në infrastrukturë duhet të jenë të jenë të ndërlidhura drejtpërdrejtë me realizimin e ndonjëris prej programeve në fushat tjera.


Struktura e Propozuar Mbarë-Sektoriale me theks të veçantë në MASHT

Sa i përket strukturës programore të bazuar në performancë, nuk ekziston ndonjë rregull i posaçëm, mirëpo rregulli i përgjithshëm është se struktura programore duhet të jetë e bazuar në politika kombëtare, dhe se duhet të jetë praktike për të siguruar informata të mira për prioritizim, buxhetim, ekzekutim, monitorim dhe vlerësim. Në bazë të dokumenteve të politikave të miratuara deri më tani, siç janë Programi i Qeverisë, Arsimit dhe Shkenca paraqet një shtyllë të rëndësishme të prioriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Duke u bazuar në këtë, do të ishte më praktike që zhvillimi, planifikimi, ekzekutimi dhe monitorimi i politikave që kanë të bëjnë me zhvillimin e dijës dhe njohurive në Kosovë të bëhet në kuadër të Sektorit të Arsimit:

Sektori mbi të cilin do të planifikohen, zhvillohen e ekzekutohen politika që kanë të bëjnë me zhvillimin e dijës dhe njohurive në Kosovë do të ishte e përshtatshëm të quhej si **Sektori i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**. Ndërsa fushat specifike të politikave në kuadër të këtij sektori të zhvillohen në kuadër të nënsektorëve siç janë;

1. Shkenca dhe Teknologjia,
2. Arsimit i Lartë,
3. Arsimit Parauniversitar i Përgjithshëm,
4. Arsimit Profesional,
5. Planifikimi dhe Administrimi

Figure 1: Pasqyrë e Përbërjes së Sektorit dhe Nënsektorëve



Nga lista më lartë shohim se në secilin nënsektor/program veprojnë organizata të ndryshme dhe njësi organizative të ndryshme të cilat janë të identifikuara si të tilla në Strukturën Buxhetore të aprovuar me buxhetin 2015.

Për shembull:

Nënsektori/programi i propozuar **Shkenca dhe Teknologjia** do të përfshinte si më poshtë:

- Organizata Buxhetore: 231 ASHAK
 - o Programi: 175 ASHAK
 - Nënprogrami: 913 ASHAK.
- Organizata Buxhetore: 2013 MASH
 - o Programi: 110 Arsimi i Lartë dhe Shkenca
 - Nënprogrami:
 - 970 Instituti Albanologjik i Prishtinës
 - 971 Instituti i Historisë i Prishtinës
 - 972 Instituti i Leposavit
 - 918 Instituti Pedagogjik
 - 982 Investime Kapitale në Arsimin e Lartë dhe Shkencë (*shënim: vetëm projektet investive për nënsektorin perkatës*)

Nënsektori/Programi i propozuar **Arsimi i Lartë** do të përfshinte si më poshtë:

- Organizata buxhetore: 208 MASHT
 - o Programi: 110 Arsimi i Lartë dhe Shkenca
 - Nënprogrami(et):
 - 917 Marrëveshjet Bilaterale
 - 919 Universiteti i Prizrenit
 - 973 Agjencia e Akreditimit
 - 974 Universiteti i Pejës
 - 977 Universiteti i Gjilanit
 - 978 Universiteti i Gjakovës
 - 979 Universiteti i Mitrovicës

982 Investimet Kapitale në Arsimin e Lartë dhe Shkencën (*Shënim: Vetëm projektet investive për nënsektorin përkatës*)

- Organizata buxhetore: 242 Universiteti i Prishtinës
 - o Programi: 112 Universiteti i Prishtinës
 - Nënprogrami: 904 Universiteti i Prishtinës

Nënsektori/Programi i propozuar **Arsimi Parauniversitar i Përgjithshëm** do të përfshinte si më poshtë:

- Organizata Buxhetore: 208 MASHT
 - o Programi: 111 Arsimi Parauniversitar
 - Nënprogrami: 900 Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
 - 908 Arsimi për Nevoja të Veçanta
 - 910 Zhvillimi i Mësimdhënësve
 - 911 Zhvillimi i Kurrikulave
 - 925 Programi i Arsimit Bazë
 - 981 Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar (*Shënim: Vetëm projektet investive për nënsektorin përkatës*)
- Organizata buxhetore: 6xx Komunat
 - o Programi: 92x Arsimi dhe Shkenca
 - Nënprogrami: 922xx Arsimi Parafillor dhe Çerdhet
 - 930xx Arsimi Fillor
 - 942xx Arsimi i Mesëm

Nënsektori/Programi i Propozuar **Arsimi Profesional** do të përfshinte si më poshtë:

- Organizata buxhetore: 208 MASHT
 - o Programi: 111 Arsimi Parauniversitar
 - Nënprogrami: 975 Agjencia e APP
 - 981 Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar (*Shënim: Vetëm projektet investive për nënsektorin përkatës*)
- Organizata Buxhetore: 6xx Komunat
 - o Programi: 92x Arsimi dhe Shkenca
 - Nënprogrami: 942xx Arsimi i Mesëm (Profesional)

Këto, njëherësh mund të jenë edhe programe në bazë të të cilave mund të ndahen resurset në kuadër të KASH-it në nivel mbarësektorial, si dhe do të përdoren si bazë për planifikim, zhvillim të politikave nënsektoriale në formë të politikave të programit.

Ndërsa një program tjetër i propozuar **Planifikimi dhe Administrimi** do të përfshinte funksionet e përbashkëta organizative, pra funksione mbështetëse për programet tjera siç mund të jenë: Administrata, Prokurimi, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Financat, Politikbërja në nivel sektorial etj.

Programi për Planifikim dhe Administrim parimisht nuk preferohet të planifikohet në nivel të produkteve/shërbimeve, pasi që aktivitetet të cilat ndërmerren nuk ofrojnë shërbime të

drejtpërdrejta për publikun, mirëpo mbështetin krijimin e produkteve/shërbimeve në kuadër të programeve tjera. P.sh. kryerja e një procedure tenderimi për një projekt ndërtimi, apo renovimi etj.

Në vijim është prezentuar skema e koordinimit në mes të Sistemit të propozuar të Planifikimit të Integruar Strategjik në nivel Qeveritar me SPI në nivel të sektorit të Arsimit. Në këtë kontekst “Komisioni për planifikim strategjik” i propozuar të krijohet në nivel të Qeverisë do të kishte përgjegjësinë primare për përcaktim të prioriteteve si për nga aspekti i politikave poashtu edhe të ndarjeve buxhetore për secilin sektor. Në mes tjerash ky Komision, në rastin e sektorit të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë do të ishte përgjegjës për rishikim të planeve që do të dorezoheshin nga Komisioni për Menaxhim Strategjik të Sektorit, komision ky që do të komunikonte në menyrë të drejtëpërdrejtë me Komisionet programore, të cilët do të jenë përgjegjës për përcaktim të objektivave në kuadër të secilit nënsektorë/program duke i respektuar kufinj të buxhetor të parapërcaktuar nga Komisioni për Menaxhim Strategjik të sektorit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.



Përmirësimet e mundshme të menjëhershme.

Duke pasur parasysh kufizimet ligjore të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshimet e bëra), kalimi nga niveli aktual i planifikimit dhe buxhetimit në nivelin mbarësektorial merr kohë, dhe kërkon ndryshime në Ligjin e lartpërmendur. Kjo do të thotë se nevojitet të gjendet një strukturë e cila është në harmoni me legjislacionin ekzistues, ndërsa nuk paraqet pengesë që në të ardhmen e afërt të arrihet qëllimi i planifikimit mbarësektorial. Prandaj, përpiluesit propozojnë që disa ndryshime në nivel organizate buxhetore janë të domosdoshme për të siguruar përmirësim në lidhjen e politikave me buxhetin duke marrë parasysh standardet e mira të buxhetimit. Këto përmirësime mund të jenë si më poshtë:

Në nivelin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:

Struktura Aktuale e Buxhetit të MASHT-it	Struktura e Propozuar
<p>Programi: Arsimi i Lartë dhe Shkenca Nënprogramet: Qendra e Studentëve Marrëveshje Bilaterale Universiteti i Prizrenit Instituti Albanologjik i Prishtinës Instituti i Leposaviçit Agjencia e Akreditimit Universiteti i Pejës Universiteti i Gjilanit Universiteti i Gjakovës Universiteti i Mitrovicës Investime Kapitale në Arsimin e Lartë dhe Shkencë</p>	<p>Programi: <i>Shkenca dhe Teknologjia</i> Në përbërje të si në vijim: - Instituti Albanologjik i Prishtinës - Instituti i Historisë Prishtinë - Instituti i Leposaviçit - Instituti Pedagogjik <i>Te gjitha këto të lartëpërmendura mund të përfshijë projekte të vogla kapitale dhe jokapitale.</i> - Projekte të mëdha kapitale për Shkencë dhe Teknologji (projektet e mëdha kapitale dhe jokapitale)</p>
<p>Programi: Arsimi Parauniversitar Nënprogramet: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve Arsimi për fëmijë me nevoja të veçanta Aftësimi i mësimdhënësve Zhvillimi i kurrikulave Instituti Pedagogjik i Kosovës Programi i Arsimin Bazë Agjencia e AAP Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar</p>	<p>Programi: <i>Arsimi i Lartë</i> Në përbërje si në vijim: - Marrëveshjet bilaterale; - Agjencia e Akreditimit; - Universiteti i Prizrenit; - Universiteti i Pejës; - Universiteti i Gjilanit; - Universiteti i Gjakovës; - Universiteti i Mitrovicës; - Projekte të mëdha kapitale dhe jokapitale në Arsim të Lartë.</p>
<p>Programi: Bashkëfinancimi me Kuvendet Komunale Nënprogrami: Bashkëfinancimi me KK në Veri Programi: Shërbimet e Administratës Nënprogrami: Administrata Qendrore Zyra e Ministrit Inspektorati i Arsimin në Kosovës</p>	<p>Programi: <i>Arsimi Parauniversitar i Përgjithshëm</i> Në përbërje si në vijim: - Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve; - Arsimi për Nevoja të Veçanta; - Zhvillimi i Mësimdhënësve; - Zhvillimi i Kurrikulave; - Programi i Arsimin Bazë; <i>Të lartë përmendurat mund të përfshijnë projekte të vogla kapitale dhe jokapitale.</i> - Projekte të mëdha kapitale dhe jokapitale Programi: <i>Arsimi Profesional</i> Në përbërje si në vijim: - Agjencia e AAP - Projekte të mëdha kapitale dhe jokapitale në Arsimin e Profesional Programi: Planifikim dhe Administrim - Administrata Qendrore - Zyra e Ministrit - Inspektorati për Arsimin në Kosovë</p>

Një përmirësim i mundshëm mund të bëhet edhe përmes modifikimit të strukturës buxhetore të buxheteve komunale. Modifikimi i tillë duhet të jetë në harmoni me prioritetet sektoriale, e nënsektoriale të nivelit qendror, përmes së cilave përcaktohen të ashtuquajtura standarde minimale, për çka edhe bëhet transferi ndërqeveritar në formë të Grantit Specifik për Arsim.

Bazuar në këtë propozohet që struktura e buxhetit komunal të modifikohet si më poshtë:

Struktura e Buxhetit të Arsimit në Nivelin Komunal aktuale	Struktura e Propozuar:
Programi: Arsimi dhe Shkenca Nën programi: Administrata Arsimi Parashkollor dhe Çerdhet Arsimi Fillor Arsimi i Mesëm	Programi: Arsimi Nën-programi: Planifikim, Administrim Arsimi i Përgjithshëm (Fillor dhe i Mesëm), Arsimi Profesional

Ndërlidhja e strukturës së re të propozuar mbarësektoriale me indikatorët e performancës

Në KASH 2015-2017, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka prezentuar indikatorët kyq të performancës të cilët janë të ndarë sipas programeve të agreguara “Arsimi parauniversitar”, “Arsimi i lartë dhe shkenca” dhe “ Shërbimet e administrata”. Edhe pse kjo paraqitje ka qënë nje hap i mirë për të matur progresin e MASHT në politika të caktuara, megjithatë në kuadër të secilit program nuk ka pasur indikator të cilët do të mundësonin plotësisht matjen e realizimit të një objektivë specifike qe ndërlidhet me programin e caktuar.

P.sh. në rastin e Objektivës së parë që ka të bëjë me **“Gjithëpërfshirjen dhe përmirësimi i cilësisë në arsimin parauniversitar”**, nëse shqyrtohet vetëm pjesa e objektivës që ka të bëjë me **“Gjithëpërfshirjen”**, indikatorët e vendosur janë të përqendruar vetëm në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta, por jo edhe indikatorë tjerë kyq për matjen e gjithëpërfshirjes së përgjithshme të nxënësve në arsim siç mund të jenë **“Shkallës e braktisjes së nxënësve”** apo indikator i mbi **“ Shkallën e pranimit të nxënësve fillestar “** e të ngjajshëm. Në këtë rast indikatorët e tillë do të mund të tregonin saktë për të arriturat dhe përmirësimin në gjithëpërfshirjen e fëmijëve ne arsimin parauniversitar, përfshirë këtu edhe përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe minoriteteve.

Në përputhje me strukturën e re mbarësektoriale të arsimit, dhe me qëllim të ndërlidhjes së kësaj strukture me indikatorët e matshëm, e poashtu duke ju referuar edhe të gjeturave nga “Raporti i Progresit 2014 – Rishikimi i Përbashkët Vjetor – Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës”, rekomandohet përfshirja e një numri shtesë të indikatorëve kyq të performancës të cilët do të ndërlidheshin drejtpërsëdrejti me nënprogramet e sugjeruara më lartë:

Programi/ Nënsektori	Indikatorët
Arsimi Parauniversitar i Përgjithshëm	1 Shkalla e regjistrimit të fëmijëve në edukim parashkollor (3-5)
	2 Shkalla e pranimit të nxënësve fillestar
	3 Nr. i fëmijëve me nevoja të veçanta

	4	Nr. i mësimdhënësve me nevoja të veçanta	
	5	Proporcioni nxënës/klasë	
	6	Shkalla e braktisjes së nxënësve	
	7	Proporcioni nxënës/mesues	
	8	Arritëshmëria ne testin e maturës	
	9	Numri i arsimtareve të licensuar	
	10	Numri i shkollave që zbatojnë kurrikulen e re	
	11	Perqindja e shkollave që operojne me më shumë nje ndërrim	
	Arsimi i Lartë	1	Mesatarja e shpenzimeve vjetore për student
		2	Mesatarja e shpenzimeve vjetore operative për student e shprehur në përqindje te BPV-se për kokë banori
		3	Nr I studentëve ne Universitet
4		Raporti student /personel akademik	
5		Pjesëmarrja në Arsimin e Lartë e grup-moshës 18-25	
6		Numri i studentëve për 100,000 banorë	
7		Numri I të diplomuarve brenda një viti akademik	
8		Nr i mobiliteteve afatshkurtër	
9		Nr i granteve vjetore të doktoraturës	
10		Graduate employment outcomes*	
Shkenca dhe Teknologjia	1	Shpenzimet e Shkencës dhe Teknologjisë në përqindje të BPV-së	
	2	Nr i stafit të shkencës	
	3	Nr i Botimeve shkencore të përgjithshme	
	4	Numri i publikimeve shkencore nga ASHAK	
	5	Numri i publikimeve shkencore nga Instituti Albanologjik	
	6	Numri i publikimeve shkencore nga Instituti I Historisë Prishtinë	
	7	Numri i publikimeve shkencore nga Instituti I Leposavicit	
Arsimi profesional	1	Numri i nxënësve dhe i kohës së aftësimin të kaluar në punë praktike në ndërmarrje	
	2	Numri i ndërmarrjeve të angazhuara në ofrimin e punës praktike	
	3	Shkollat me pajisje të duhura	
	4	Nr i shkollave me udhezues per karriere	

Shtojca 1: Draft Struktura e KASH-it Sektorial

Struktura e KASH-it mbarë-sektorial:
Draft për Diskutim

		Arsimi, Shkenca dhe Teknologjia					
		Shkenca dhe Teknologjia	Arsimi I Lartë	Arsimi I Përgjithshëm Parauniversitar	Arsimi Profesional	Planifikimi dhe Administrimi	
231	Akademia e Shkencave dhe Arteve						
175	Akademia e Shkencave dhe Arteve						
913	Akademia e Shkencave dhe Arteve						
208	MASHT						
110	Arsimi i Lartë dhe Shkenca						
970	Instituti Albanologjik I Prishtinës	905	Qendra e Studentëve				
971	Instituti I Historisë Prishtinë	917	Marrëveshjet Bilaterale				
972	Instituti I Leposavicit	919	Universiteti i Prizrenit				
982	Investime Kapitale në Arsimin e Lartë	973	Agjencia e Akreditimit				
918	Instituti Pedagogjik I Kosovës	974	Universiteti I Pejës				
982	Investimet Kapitale në A. Lartë dhe Shkencë	977	Universiteti I Gjilanit				
		978	Universiteti I Gjakovës				
		979	Universiteti I Mitrovicës				
		982	Investimet Kapitale në A. Lartë dhe Shkencë				
111	Arsimi Parauniversitar						
				900	Autoriteti Kombëtar I Kualifikimeve	975	Agjencia e AAP
				908	Arsimi për Nevoja të Veçanta	981	Invest. Kapitale në Ars. Parauniversitar
				910	Zhvillimi I Mësimdhënësve		
				911	Zhvillimi I Kurrikulave		
				925	Programi I Arsimit Bazë		
				981	Investimet Kapitale në Ars. Parauniversitar		
155	Administrata e Përgjithshme					113	Administrata e Përgjithshme
						114	Zyra e Ministrimit
						980	Inspektorati I Arsimit në Kosovë
242	Universiteti i Prishtinës						
112	Universiteti I Prishtinës	904	Universiteti i Prishtinës				
6xx	Komunat						
6xx	Arsimi dhe Shkenca			924xx	Arsimi Parafillor	942xx	Arsimi I Mesëm (56%)
				933xx	Arsimi Fillor (44%)		
				942xx	Arsimi I Mesëm (44%)	920xx	Administrata

Shtojca 2: Struktura e Propozuar për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Arsimi, Shkenca dhe Teknologjia

Struktura e Propozuar e Buxhetit të MASH-it

208		Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë					
Struktura e Propozuar							
	Shkenca dhe Teknologjia	Arsimi I Lartë	Arsimi I Përgjithshëm Parauniversitar	Arsimi Profesional	Planifikimi dhe Administrimi		
Struktura Ekzistuese	110	Arsimi i Lartë dhe Shkenca					
	970	Instituti Albanologjik I Prishtinës	905	Qendra e Studentëve			
	971	Instituti I Historisë Prishtinë	917	Marrëveshjet Bilaterale			
	972	Instituti I Leposavicit	919	Universiteti i Prizrenit			
	982	Investime Kapitale në Arsimin e Lartë	973	Agjencia e Akreditimit			
	918	Instituti Pedagogjik I Kosovës	974	Universiteti I Pejës			
	9xx	Projektet kapitale në shkencë dhe teknologj	977	Universiteti I Gjilanit			
			978	Universiteti I Gjakovës			
			979	Universiteti I Mitrovicës			
			9xx	Projektet kapitale në Arsimin e Lartë			
	111	Arsimi Parauniversitar					
				900	Autoriteti Kombëtar I Kualifikimeve	975	Agjencia e AAP
				908	Arsimi për Nevoja të Veçanta	9xx	Projekte Kapitale në Ars. Prof..
				910	Zhvillimi I Mësimdhënësve		
				911	Zhvillimi I Kurrikulave		
				925	Programi I Arsimit Bazë		
				9xx	Projektet Kapitale në Ars. Përgj. Paraun		
	155	Administrata e Përgjithshme					
						113	Administrata e Përgjithshme
						114	Zyra e Ministrit
					980	Inspektorati I Arsimit në Kosovë	

Shtojca 3: Struktura e Propozuar e Buxhetit për ARsimin në Nivelin Komunal

Arsimi, Shkenca dhe Teknologjia

Struktura e Propozuar e Buxhetit të Arsimit në Nivelin Komunal

6xx Komunat

Struktura e Propozuar							
920		Arsimi					
Struktura Ekzistuese		920xx	Planifikim dhe Administrim	922xx	Ars. I Përgjithsh. Parauni.	933xx	Arsimi Profesional
	920	Arsimi dhe Shkenca					
		920xx	Administrata	924xx	Arsimi Parashkollor dhe Çerdhet	945xx	Arsimi Profesional
				933xx	Arsimi Fillor		
				945xx	Arsimi I Mesëm		

Shtojca 4: Struktura e Programit

Zakonisht struktura e programit vendoset sipas nevojave të politikbërësve dhe kërkesave për monitorim dhe kontrollim të financave publike. Sidoqoftë një strukturë e mirë e programit, duhet më së miri t'i përshtatet vendimmarrësve pasi që mundëson menaxhim më të lehtë të politikave në kuadër të programit, dhe për të siguruar se qëllimet e politikave arrihen përmes objektivave afatmesme dhe produkteve/shërbimeve të cilat planifikohen në kuadër të buxhetit, dhe reflektohen në Planin e Punës së Ministrisë, e gjithashtu edhe Planin Vjetor të Ministrisë.

Një program duhet të përmbajë aktivitetet dhe punën që lidhjet me një fushë të politikës, që në rastin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, këto fusha janë nënsektorët përkatës. Më poshtë japim disa prej kërkesave të programit:

Titullit	Përshkrimi	Niveli
<i>Përshkrimi i politikës së programit</i>	Paraqet një përshkrim të përgjithshëm të metodave kryesore që programi synon të përdorë për arritjen e qëllimeve dhe objektivave. Këtu mund të përshkruhet edhe çfarëdo aranzhimesh menaxhuese që sektori/ministria zgjedh për menaxhimin e politikave në kuadër të programit.	Strategjik/Politikbërës
<i>Rezultatet përfundimtare dhe qëllimet e programit</i>	Këto duhet të përcaktohen në mënyrë specifike dhe të matshme, mirëpo arritja e tyre më shumë është e dëshiruar, pasi që kemi të bëjnë me synime afatgjata. Përcaktimi i qartë i tyre, lehtëson edhe përcaktimin e treguesve të performancës. Qëllime të tilla e të dëshiruara do të ishin: Rritja e % të kalueshmërisë së testit të maturës për x% deri në vitin 2020. Ulja e shkallës së lënies së shkollimit për x% deri në vitin 2022. Etj.	Strategjik/Politikbërës
<i>Objektivat Afatmesme</i>	Objektivat afatmesme duhet të jenë SMART e të formuluar për periudhën afatmesme. Objektivat afatmesme janë vetëm hapa të ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimeve apo rezultateve përfundimtare, mirëpo fakti që duhet të jenë real dhe në kuadër të mundësive dhe resurseve në dispozicion, i dallon nga qëllimet, dhe nuk i bën të dëshiruar, por synim specifik për t'i arritur. P.sh. Eliminimi i ndërrimit të tretë deri në vitin 2019. Ndërrimi i tretë zakonisht shkaktohet nga mbingarkesa e objekteve shkollore, dhe një fenomen i tillë zakonisht shfaqet në zona urbane. Si zgjidhje mund të jetë, ndërtimi i hapësirave të reja, që	Strategjik/Politikbërës / Operativ (3 vjeçar)

	mund të aranzhohet si projekt, dhe ofrimi i shërbimeve të transportit, për transportimin e nxënësve në shkolla me mungesë të nxënësve në krahasim me sipërfaqen. Kjo na sjellë te definimi i produkteve.	
Produktet	Produktet janë të mirat dhe shërbimet që duhet krijuar apo prodhuar për arritjen e objektivave dhe qëllimeve. Nëse marrim shembullin e mëhershëm, produkt mund të jetë: Ndërtimi i xx m ² i hapësirave shkollore në vitin e 1-rë, vitin e 2-të, vitin e 3-të. Xx publikime shkencore në lëmi të ndryshme në vitin 1, xx në vitin 2, xx në vitin 3.	Operativ (1-3 vjeçar)
Aktivitetet	Veprimet specifike që kryhen për të prodhuar apo krijuar një produkt. P.sh. <ul style="list-style-type: none"> - Shpallja e thirrjes për hulumtime shkencore. - Analizimi i rezultateve, - Përzgjedhja; - Publikimi etj. Janë aktivitetet ato që përdorin resurse si në njerëz ashtu edhe në materiale, ku duhet pasur kujdes në buxhetimin e tyre në planin kontabël.	Operativ 1 vjeçar.